



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:227650  
Datë: 26.11.2024  
Numri i dokumentit: 06509869

**P.nr. 774/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit, H.Th., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë -Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2113/23, të dt. 07.06.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit publik fillestar, të dt. 13.11.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Lumturije Hoxha, të pandehurit H.Th., mbrojtëses së të pandehurit av. .... sipas autorizimit, dhe përfaqësuesit të autorizuar te dëmtuarit av. Besnik Nikçi, me dt. 15.11.2024, mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.26.11.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri

**H.TH.**, i biri i ..... dhe nënës ....., e gjinisë ....., i lindur me dt. ...., në fsh. D., K. D., ku edhe banon, ka të kryer shkollën e mesme, me lnj.nr....., i martuar, pensionist, i gjendjes së dobët, ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, ka qenë nën masën e paraburgimit nga dt. 24.10.2023, e deri me dt. 20.11.2023 dhe nën masën e arrestit shtëpiak ka qenë nga dt. 20.11.2023, e deri me dt. 19.12.2023.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse,**

Me datë 24.10.2023, rreth orës 15:20, në magjistralen Prishtinë-Pejë, pikërisht në fshatin L., Komuna P., nga pakujdesia shkel ligjin Nr. 05/L-088 mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe atë nenin 41 dhe 54, duke rrezikuar jetën e njerëzve apo pasurinë ku me këtë rast shkaktohet vdekja e drejtuesit të veturës së KFOR-it, këtu C. C., në atë mënyrë që derisa i pandehuri H.Th.,

ishte duke drejtuar automjetin e tij “A” të tipit “.....”, me targa te regjistrimit ....., dhe po qarkullonte në magjistralen Prishtinë-Pejë, me të arritur në fshatin L., duke mos iu përshtatur kushteve të rrugës, shpejtësisë dhe shenjën e trafikut vijë e plotë del me automjet nga ana e vet e djathtë e rrugës në anën e majtë të rrugës e destinuar për lëvizjen e mjeteve nga kahja e kundërt, ku në një distancë të afërt përball tij ishte duke lëvizur automjeti “.....”, ngjyrë e gjelbër, me targa ....., në shiritin e tij të djathtë të qarkullimit, me të cilin rast e godet me pjesën e parë ballore të anës së majtë të automjetit “A” në pjesën e parë po ashtu ballore të anës së majtë të automjetit “B” të KFOR-it, ku si pasoje e aksidentit përpos dëmeve materiale dhe lëndimeve trupore të pasagjeres, humb jetën drejtuesi i automjetit “B” këtu viktimja C. C. (ushtar i KFOR-it),

-me çka ka kryer veprë penale **Rrezikim i trafikut publik** nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 7, 38, 40, 42, 59 par. 2 nen par. 2.5 e lidhur me nenin 64 par. 2, 69, 70, neni 370 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 te KPRK-së dhe nenit 364 të KPP-së, të pandehurin e:

## G J Y K O N

- Dënim me Burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, me të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 24.10.2023, e deri me dt. 20.11.2023 dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga dt. 20.11.2023, e deri me dt. 19.12.2023, e të cilin dënim i pandehuri do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 64 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptohet

## DËNIMI PLOTËSUES – NDALIMI I DREJTIMIT TË AUTOMJETIT

-Te pandehurit i ndalohet drejtimi i automjetit në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Koha e kaluar në burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi

- I pandehuri obligohet në pagimin e paushallit gjyqësor, shumen prej 100 (njëqind) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 20 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Pala e dëmtuar, përfaqësuesi ligjor i të ndjerit C. C., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.2113/23, të dt. 07.06.2024, ndaj të pandehurit H.Th., për shkak të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPP-së, me dt. 13.11.2024, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar, ku prezentë ishin Prokurori i Shtetit, Lumturije Hoxha, i pandehuri H.Th., mbrojtësja e të pandehurit av. .... sipas autorizimit, dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, av. ....

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par. 1 të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe ka shtuar se për mbrojtës ka angazhuar avokaten .....

Pas leximit të aktakuzës së nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, i vie keq për rastin e ndodhur.

Prokurori i Shtetit deklaroi se, pasi që i pandehuri i shfrytëzoi të drejtat e tij procedurale për tu deklaruar, i njëjti pas konsultimit me mbrojtësen e tij, i vetëdijshëm për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë, bëri pranimin e fajësisë, e ky pranim ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, andaj gjykatës i propozon që ta aprovojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me interes për palën e dëmtuar, rezulton kërkesa pasurore juridike dhe në atë drejtim ka qenë i fokusuar në rrjedhën e epilogut.

Mbrojtësja e të pandehurit, ka deklaruar se, pajtohet me deklarinimin e të mbrojturit të tij rreth pranimin të fajësisë, pranim ky mbi bazën e vullnetit të tij dhe i paraqitur qysh në fazën hetimore, akoma pra pa u ngritur aktakuza ndaj tij.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 241 dhe 242 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështetet aktakuza siç janë: procesverbal mbi vend shikimin e aksidentit datës 29.10.2023, skica e vendit të ngjarjes, ekspertiza e komunikacionit e datës 04.11.2023, fotografitë e siguruar nga vendi i ngjarjes, bashkangjitur shkresave të lëndës, deklarata e të pandehurit H.Th., e dhënë në Prokurorinë Themelore në Pejë me datë 22.02.2024, certifikata e konstatimit të vdekjes, për viktimën C. C., lëshuar nga Komanda Rajonale – Perëndim, ITALFOR GSA – SPT BN, raportet mjekësore për të dëmtuarën D. N., pasagjere në veturën e aksidentuar të KFOR-it, raportet mjekësore për të pandehurin H.Th., si dhe shkresat tjera të

lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj Gjykata konform nenit 242 par 6 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit H.Th., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, Rrezikim i Trafikut Publik, nga neni 370 par. 9 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë Gjykata gjeti se i pandehuri veprën penale e ka kryer nga pakujdesia.

Prokurorja e Shtetit, lidhur me rrethanat për dënimin deklaroi, sa i përket rrethanave lehtësuese për të pandehurin gjykatës i propozon që të merr pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanat rënduese ia lë në vlerësim gjykatës.

Përf. I aut. i palës së dëmtuar deklaroi se, nuk ka çka të shtoj lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe të njëjtat ia lë në vlerësim gjykatës.

Mbrojtësja e të pandehurit deklaroi se, kjo veprë penale e kryer nga pakujdesia, pavarësisht pasojës në këtë rast, ka goditur pothuajse ekuivalent edhe të akuzuarin. I njëjti nga ky aksident, ose them ligjërisht me këtë veprë penale ka gjymtuar vetën e tij fillimisht, duke mbet i palëvizshëm, duke kaluar deri me tani në 6 operacione, e presin edhe 2 të tilla shumë shpejtë, kështu që shtuar gjithë këtyre rrethanave të cilat sipas bindjes se mbrojtësit, imponojnë të zbatohet një dispozitë e veçantë ligjore që është neni 74 i KPRK-së, e cila dispozitë ligjore i referohet bazave të posaçme të lirimit nga dënimi për vepra penale të kryera nga pakujdesia, sikurse është vepra penale për të cilën akuzohet H.Th. dhe të cilën e ka pranuar sa i përket fajësisë, kështu që konform nenit 74 par.1, përcakton se gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale të kryer nga pakujdesia në rastet e mëposhtme, ku pika 1.1 përcakton, nëse pasojat e asaj veprë penale e godasin kryesin aq rëndë, sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij. Mendon se në këtë çështje penale, pikërisht gjen zbatim kjo dispozitë ligjore sepse pasojat si kryes i asaj veprë kanë dëmtuar në shkallën më të lartë edhe të akuzuarin, është absolut dënimi më i rëndë se cili do dënim që mund t'ia shqiptonte gjykata. Si rrethana lehtësuese formale shton faktin se është hera e parë sigurisht edhe e fundit që bie ndesh me ligjin, pranimin e fajësisë qysh në fazën e hershme të procedurës penale, moshën e tij të shtyrë si pensionist, por edhe atë se çfarëdo dënimi tjetër ti shqipton gjykata do të ishte kokëçarje e madhe për zbatuesit, apo ekzekutuesit të atij dënimi.

I pandehuri H.Th. deklaroi se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtëses së tij.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Rrethana lehtësuese për të pandehurin Gjykata mori, pranimin e fajësisë për veprën e kryer, të cilin pranim i pandehuri e ka bërë në të

gjitha fazat e procedurës penale, faktin se është hera e pare që i pandehuri ka rënë ndesh me ligjin dhe ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, moshën e të pandehurit pasi që i pandehuri tani është pensionist, faktin se edhe vetë i pandehuri ka pësuar lëndim trupore nga ky aksident, e po ashtu edhe jeta e tij ka qenë e rrezikuar në këtë aksident., andaj duke pas parasysh rrethanat lehtësuese të cekura më lartë Gjykata vlerësoj se një dënim i tillë është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit.

Gjykata vlerësoj se ndaj të pandehurit është e nevojshme shqiptimi i dënimit plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit, në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, konform nenit 64 par 2 të KPRK-së, duke pasë parasysh pasojat e shkaktuara me veprën penale.

Ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit, Gjykata nuk gjeti. Gjatë vlerësimit të rrethanave rënduese me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit Gjykata pati parasysh, pasojat e shkaktuar me këtë veprë penale, mirëpo meqenëse këto pasojë inkorporohen me rastin e kualifikimit të veprës penale sipas paragrafëve të caktuara të njëjta rrethana nuk mund të llogariten si rrethanat rënduese edhe me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese nga ana e gjykatës, pasi që do të kishim duplikim të rrethanave rënduese. Pasojat e shkaktuara me veprën penale janë rrethana që ndikojnë në kualifikimin e veprës penale sipas paragrafit 9 dhe 6 të nenit 370 të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Konform nenit 64 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptohet dënimi plotësues-ndalimi i drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve. Koha e kaluar në burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, Gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar konform nenit 462 të KPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, Gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,  
P.nr.774/24 dt. 26.11.2024**

**Bashkëpunëtorë profesionale**  
Selvane Bukleta

**G J Y Q T A R I**  
Shaqë Curri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar  
ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita  
e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë,  
e nëpërmjet të kësaj gjykate.